



VENDIM

Nr.78 Datë 24.07.2013

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “MAKSI ELEKTRIK” SH.P.K ME
NR.30, SERIA PV06P, LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE-S NR. 1, DT. 11.01.2006**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa”b”, pika 3 pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.07.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “MAKSI ELEKTRIK” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.30, Seria PV06P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.1, datë 11.01.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “MAKSI ELEKTRIK” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

• **Neni 15, pika 4, germa “a”:**

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

• **Neni 15, pika 4, germa “b”:**

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për te kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e liçensës së shoqërisë “MAKSI ELEKTRIK” me numër Nr.30, seri PV06P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec-et “Leskovik 1” me fuqi 72 KW dhe “Leskovik 2” me fuqi 100 KW, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.1, dt. 11.01.2006.
2. Fuqia e instaluar e Hec “Leskovik 1” nga 72 KW të bëhet 1072 KW dhe fuqia e instaluar e Hec “Leskovik 2”, nga 100 KW te behet 1100 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI